

www.gjykataelarte.gov.al



REVISTA DIGJITALE

DIALOG JURIDIK

REFLEKTIME GJYQËSORE

2026

Gjykata e Lartë në epokën digjitale: përtej vendimmarrjes, drejt komunikimit publik

Ida Vodica

Drejtoreshë e Marrëdhënieve me Publikun dhe me Jashtë

Në një shoqëri ku informacioni qarkullon në kohë reale dhe ku publiku informohet gjithnjë e më shumë përmes platformave digjitale edhe drejtësia u përball me një sfidë të re:

Të mos mbetet thjesht prodhuese e vendimeve, por të zhvillonte më tej komunikimin me publikun edhe nëpërmjet platformave të tjera.

Për një kohë të gjatë, ndërveprimi i gjykatave me publikun ka qenë i përqëndruar kryesisht nëpërmjet njohjes me vendimet gjyqësore të cilat kanë qenë të aksesueshme për profesionistët e së drejtës ose palët në proces, pas komunikimeve me sekretarinë gjyqësore apo pas publikimit në faqen zyrtare. Por, në një shoqëri demokratike gjithnjë e më shumë drejt digjitalizimit, kjo marrëdhënie nuk është më e mjaftueshme.

Nga vetë roli kushtetues i Gjykatës së Lartë, i cili lidhet me njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore, komunikimi si mjet njohës, drejtohet padyshim ndaj gjykatave të të gjitha niveleve, avokatëve, komunitetit juridik, gazetarëve dhe publikut të gjerë, i cili, pavarësisht formimit profesional, është i interesuar për të njohur më shumë rreth jurisprudencës dhe zhvillimeve gjyqësore.

Kjo qasje nuk është thjesht një zgjedhje institucionale, por një domosdoshmëri që buron nga vetë natyra e së drejtës dhe raporti i saj me shoqërinë. Nuk mund të pretendohet se të gjithë e njohin ligjin, edhe pse mosnjohja e tij nuk përbën shkak për të mos iu bindur atij. Për këtë arsye, ekziston detyrimi për t'u dhënë qytetarëve mjetet e nevojshme për ta kuptuar atë. E drejta prek të gjitha fushat e jetës dhe trajton çështje që shpesh janë objekt debati në hapësirën publike. Është e rëndësishme që çështje të cilat prekin jetën familjare, profesionale, apo çështje të mëdha shoqërore, si dhe ndëshkimi i shkeljeve ligjore, të arrijnë tek publiku në mënyrë të qartë dhe të aksesueshme për të siguruar jo vetëm njohjen por edhe kuptimin e saktë e tyre.

Tradicionalisht, gjykatat kanë pasur një rol të rezervuar në raport me publikun, duke komunikuar më këtë të fundit kryesisht përmes vendimeve dhe, në raste të veçanta, përmes njoftimeve për median. Megjithatë, zhvillimi i teknologjisë dhe ndryshimi i mënyrës së konsumimit të informacionit kanë sjellë një transformim të këtij raporti. Komunikimi nuk shihet më si një funksion dytësor, por si një zgjatim i përgjegjësisë institucionale për transparencë.

Një gjykatë që komunikon qartë dhe në kohë reale kontribuon jo vetëm në informimin e publikut, por edhe në rritjen e besimit tek drejtësia.

Në këtë kontekst, rrjetet sociale sjellin një ndryshim thelbësor në mënyrën e shpërndarjes së informacionit. Ato e transformojnë informacionin juridik nga një përmbajtje “e arkivuar” që bëhet e disponueshme pas një kërkesë drejt një përmbajtjeje aktive, që i shkon publikut aty ku ai ndodhet.

Sot, Gjykata e Lartë është e vetëdijshme se veçanërisht rrjetet sociale, përbëjnë një mjet efektiv për të përmbushur këtë mision në kuadër të aksesueshmërisë. Ideja që informacioni mund t'i përcillet publikut në kohë të shpejtë dhe thjeshtë, përbën një hap të rëndësishëm drejt një komunikimi më të hapur. Në një kohë kur qytetarët kërkojnë informacion të thjeshtë, të shpejtë dhe të kuptueshëm, rrjetet sociale nuk janë më thjesht një mjet komunikimi, por një medium ku gjyqësori takohet natyrshëm me publikun.

Ndryshe nga mediat tradicionale, të cilat funksionojnë përmes përzgjedhjes editoriale, hierarkive redaksionale dhe prioriteteve të përcaktuara nga vetë mediumi, rrjetet sociale i japin institucionit mundësinë të komunikojë drejtpërdrejt, pa ndërmjetës dhe mbi të gjitha në kohë reale. Kjo natyrë i mundëson institucionit jo vetëm të përcjellë informacionin pa deformime ose reduktime që mund të vijnë nga përzgjedhja mediatike, por edhe të ruajë integritetin e mesazhit institucional në formën e tij origjinale. Për më tepër, rrjetet sociale krijojnë një komunikim horizontal, ku publiku nuk është vetëm marrës pasiv i informacionit, por edhe një aktor që reagon, ndërvepron dhe kërkon sqarime, duke e bërë komunikimin më dinamik dhe më gjithëpërfshirës.

Kjo liri komunikimi shoqërohet edhe me një fleksibilitet më të madh në formën dhe gjuhën e përdorur, duke i lejuar institucionit të përshtatë mesazhin sipas nevojave të audiencës pa cenuar saktësinë juridike. Në këtë kuptim, rrjetet sociale nuk zëvendësojnë mediat tradicionale, por plotësojnë ato, duke krijuar një kanal paralel komunikimi që forcon transparencën, rrit aksesin në drejtësi dhe kontribuon në ndërtimin e një raporti më të drejtpërdrejtë dhe më të besueshëm me publikun.

Në këtë kuadër, Gjykata e Lartë ka investuar në rrjetet sociale duke krijuar llogari zyrtare në **LinkedIn**, **Facebook** dhe **YouTube**. Këto platforma numërojnë sot mbi 14000 ndjekës në LinkedIn dhe mbi 3200 ndjekës në Facebook, ndërsa faqja zyrtare e gjykatës, në ndërveprim me rrjetet sociale, vizitohet mesatarisht nga rreth 2 milionë përdorues në vit.

Çdo rrjet social arrin një audiencë të ndryshme. Facebook, edhe pse në vitet e fundit ka shfaqur një rënie në raport me platformat e tjera, vijon të mbetet një hapësirë e rëndësishme për një publik mbi 40 vjeç. Këta përdorues kanë tendencë të qëndrojnë në rrjetin e brezit të tyre dhe e kanë më të vështirë të kalojnë në platforma të reja. Facebook i mundëson Gjykatës të arrijë publikun mbi 40-50 vjeç, me rreth 3200 ndjekës, prej vitit 2020, ndërkohë që audiencia me profesionale ka ardhur me krijimin e një llogarie në rrjetin LinkedIn. Sot kjo platformë është një mundësi e favorshme dhe për shkëmbim informacioni profesional dhe shoqëror. Me mbi 14 mijë ndjekës, LinkedIn është rrjeti kryesor ky Gjykata përcjell informacion relevant për të gjithë profesionistët e së drejtës. Mund të thuhet me bindje të plotë se LinkedIn është platforma ku ka më shume ndjekës “besnikë” dhe ndërveprimi me ta është maksimal. Kjo tregon interesin për institucionin dhe simbolikën e tij. Të gjithë përdoruesit e LinkedIn janë të vetëdijshëm për rëndësinë e komunikimit dhe angazhohen

gjithashtu edhe për të shpërndarë postimet e gjykatës me përmbajtje sipas tyre interesante, gjë që tregon se informacioni jo vetëm që përcillet por shihet i rëndësishëm për tu bërë i njohur në një grup gjithmonë e më të madh. Gjykata e Lartë është gjithashtu prezente edhe në YouTube, ku publikohen konferenca e ceremoni, intervista, deklarata vizive dhe video informuese për publikun. Prania në të gjitha këto platforma garanton akses të barabartë në kohë dhe informacion për të gjithë publikun.

Rrjetet sociale dhe menaxhimi i balancuar i komunikimit

E megjithatë, përtej përfitimeve të ndërlidhjes, rrjetet sociale funksionojnë shpesh mbi logjikën e vëmendjes dhe viralitetit, ndërsa drejtësia kërkon seriozitet, maturi dhe respekt për palët. Një komunikim i pakujdesshëm mund të rrezikojë të banalizojë vendimmarrjen gjyqësore ose të krijojë perceptime të gabuara. Në këtë kontekst, sfida qëndron në gjetjen e një balance të mirë menduar: të komunikohet në mënyrë të kuptueshme dhe tërheqëse, pa rënë pre e sencacionit. Një vendim gjyqësor mbetet, para së gjithash, zgjidhje e një konflikti real mes palësh dhe kjo duhet reflektuar në çdo formë komunikimi sepse në thelb ndikimi që rrjetet sociale kanë në formimin e besimit të publikut tek drejtësia është një realitet tashmë i pranuar. Transparenca, aksesueshmëria dhe mundësia për të kuptuar më mirë vendimmarrjen gjyqësore janë elementë që kontribuojnë në forcimin e këtij besimi.

Në këtë kuadër, prania e Gjykatës së Lartë në rrjetet sociale nuk është më thjesht një zgjedhje, por një domosdoshmëri e kohës. Ajo përfaqëson një hap real drejt një drejtësie më të hapur, më të kuptueshme dhe më pranë qytetarit. Përgjithësisht reagimet janë shumë pozitive kryesisht nga profesionistët të fushës, gjyqtarë, juristë, studentë dhe profesorë të së drejtës dhe studentë.

Njohja me gjykatën jo vetëm një çështje mjete, por edhe përmbajtjeje

Të gjitha vendimet që shoqërohen me njoftime për median publikohen në rrjetet sociale. Kjo ndodh për vendimet e Kolegjeve të Bashkuara, vendimet njësuere të Kolegjeve Administrative, Civile e Penale për ndryshimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore, si dhe për vendime të tjera që paraqesin interes për publikun. Jo çdo vendim ka të njëjtën rëndësi për publikun. Përzgjedhja bazohet në disa kriterë: rëndësia juridike, ndikimi në jetën e përditshme dhe lidhja me çështje që janë objekt debati në shoqëri. Për të ofruar një qasje më të kuptueshme për publikun e gjerë njoftimet për këto lloje vendimmarrjesh përdorin një gjuhë të thjeshtë e cila orienton lehtë publikun e gjerë dhe atë të specializuar.

Në të njëjtën kohë Gjykata e Lartë është përpjekur që të ushqejë dhe kërkesën e lexuesit profesional të gjykatës. Në këtë kuadër një rol të rëndësishëm në shpërndarjen dhe sistemimin e informacionit juridik luan edhe Qendra e Dokumentacionit e Gjykatës së Lartë, e cila siguron mbledhjen, organizimin dhe arkivimin e vendimeve gjyqësore, duke krijuar një bazë të strukturuar të dhënash në funksion të transparencës dhe kërkimit ligjor nëpërmjet sistemit JUDIX. Buletini Informativ Periodik dhe Tematik përbën një instrument thelbësor të shpërndarjes së jurisprudencës dhe hapjes së gjykatës ndaj kërkuesit profesional. Ai synon të ofrojë një përmbledhje të strukturuar të jurisprudencës më të rëndësishme, të organizuar sipas fushave të së drejtës dhe tematikave specifike. Buletini nuk është thjesht një publikim formal, por një mjet analitik që i ndihmon

gjqtarët, avokatët, akademikët dhe studentët të ndjekin zhvillimet më të fundit në praktikën gjyqësore dhe të kuptojnë drejtimit kryesore të interpretimit juridik. Në të njëjtën linjë, Qendra e Dokumentacionit luan një rol kyç në garantimin e cilësisë dhe saktësisë së informacionit të publikuar duke shërbyer si pikë reference për kërkime juridike dhe si një garanci e shtuar e analizës së qëndrueshme të jurisprudencës së Gjykatës së Lartë.

Transformimi i Gjykatës së Lartë nga një institucion që prodhon vendimmarrje thelbësore për sistemin juridik, në një aktor që komunikon në mënyrë aktive dhe të strukturuar me publikun, shënon një kthesë të rëndësishme në kulturën juridike dhe institucionale të vetë gjykatës.

Në këtë kontekst, lind natyrshëm pyetja: a ka ndryshuar komunikimi digjital vetëm mënyrën se si publiku i percepton gjykatat apo ka ndikuar edhe në vetë sjelljen dhe kulturën brenda gjykatës?

Ekspozimi më i madh publik, ritmi i shpejtë i informimit dhe ndërveprimi i drejtpërdrejtë me audiencën nuk kanë mbetur pa efekt brenda vetë institucionit. Përkundrazi, ato kanë kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë për rolin e tyre jo vetëm si vendimmarrës, por edhe si bartës të një përgjegjësie më të gjerë publike. Pa cenuar në asnjë moment pavarësinë e vendimmarrjes, kjo dinamikë e re ka nxitur një kujdes më të madh në arsyetim, në strukturimin e vendimeve dhe në qartësinë e mesazhit që ato përcjellin. Gjykata e Lartë, për vetë pozitën e saj në hierarkinë gjyqësore, është e vetëdijshme se nuk është vetëm hallka që zgjidh çështje konkrete, por edhe një institucion që vendos standarde dhe shërben si model për të gjithë gjyqësorin. Ky evoluim nuk është thjesht produkt i teknologjisë, por një përgjigje ndaj një kërkese më të thellë: që drejtësia të mos mbetet e mbyllur në gjuhën e saj teknike, por të bëhet e kuptueshme, e aksesueshme dhe e prekshme nga qytetari. Megjithatë, sikurse u theksua edhe më sipër, kjo hapje mbart një tension të pashmangshëm midis nevojës për thjeshtëzim dhe detyrimit për saktësi, midis shpejtësisë së komunikimit dhe maturisë së arsyetimit gjyqësor. Në këtë hapësirë delikate, sukcesi i komunikimit institucional nuk matet vetëm me numrin e ndjekësve ose ndërveprimeve, por me aftësinë për të ruajtur integritetin e vendimmarrjes dhe për të kultivuar një publik që jo vetëm informohet, por edhe kupton.

“Nëse shikojmë përpara, sfidat vetëm do të shtohen. Inteligjenca artificiale, deepfake-et dhe manipulimi algorik do të vënë në provë aftësinë e punonjësve të gjykatës për të kontrolluar mënyrën se si drejtësia paraqitet online. Por parimi mbetet i njëjtë: besimi publik është mbrojtja më e fuqishme që mund të bëhet dhe besimi nuk ndërtohet në heshtje; ai ndërtohet përmes kuptimit dhe komunikimit. Në epokën digjitale, beteja për pavarësinë është zhvendosur nga salla e gjyqit në agorën digjitale, por detyra e institucionit mbetet e pandryshuar: të sigurohet që e vërteta dhe arsyeja të triumfojnë mbi zhurmën dhe narrativën”ⁱ

Drejtësia që komunikon bëhet më e përgjegjshme, më transparente dhe më e ekspozuar ndaj vlerësimit publik një zhvillim që, nëse menaxhohet me kujdes, e forcon besimin tek sistemi dhe thëllon vetëdijen juridike në shoqëri.

ⁱ Prof. Dr. Sokol Sadushi, Kryetar i Gjykatës së Lartë të Shqipërisë - “Pavarësia Gjyqësore nën Presionin Digjital: Ndërtimi i Zërit Digjital të Drejtësisë”, Hagë, Holandë 13-15 nëntor 2025